

## NË ËMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda,** gjyqtarja Afërdita Bytyçi, më pjesëmarrjen e sekretares juridike Fahrije Beha, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.R. nga fshati S., Komuna e D., për shkak të veprës penale, Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.755/2015, datë 05.05.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik më datë 03.10.2016, në prezencën e prokurorit të shtetit Besa Limani dhe të akuzuarit, mori dhe të njëjtën ditë shpalli publikisht këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari H. R., i biri i Rr. dhe M. e gjinisë B., i lindur më *data e lindjes...*, më dok.id.-letërnjoftim më nr. personal *numër personal...*, nga fshati S., Komuna e D., ka të kryer shkollën e mesme, polic, i martuar, baba i tetë fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Ka mbajtur në pronësi armë, në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, në atë mënyrë që më datë 27.05.2015 rreth orës 11:00, në shtëpinë e tij në fshatin S., policia gjatë kontrollimit të shtëpisë së të akuzuarit ka gjetur dhe sekuestruar një pushkë gjuetie e tipit “Altay Magnum”, cal.12 mm, më nr. serik 6150383 dhe një pushkë ajrore e tipit “Diana”, nr.25,-

- më këtë ka kryer veprën penale, Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,41,51,52,73 të KPRK-së, dhe nenit 360, 361 dhe 365 të KPPRK-së, e

## **G J Y K O N**

Më dënim me burg në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

## **DËNIMI PLOTËSUES**

Të akuzuarit konformë nenit 69 të KPRK-së, i konfiskohet një pushkë gjuetie e tipit “Altay Magnum”, cal.12 mm, më nr. serik 6150383 dhe një pushkë ajrore e tipit “Diana”, nr.25.

Obligohet i akuzuari që t’i paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP/I.nr.755/2015, datë 05.05.2016, ka akuzuar H. R., për shkak të veprës penale, Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 03.10.2016, ku prokurorja e shtetit Besa Limani, lexoi aktakuzën dhe menjëherë pas leximit të aktakuzës i akuzuari H.R. ka pranuar fajësinë duke deklaruar se ndjehet fajtor për veprën penale të kryer, dhe ka shtuar se është i penduar për veprën e kryer. I ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë t’aprovojë dhe t’a këtë parasysht si rrethanë lehtësuese më rastin e matjes së dënimit.

Pas deklarimit të akuzuarit se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, të cilin pranim të fajësisë e ka bërë duke qenë i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, me të cilin pranim fajësie është pajtuar edhe prokurori i shtetit, gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kushtet nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së, pikërisht se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, të pranuar nga i akuzuari, prandaj gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit sepse janë përmbushur kushtet për pranimin e fajësisë nga neni 248 par.1 të KPPRK-së.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë, gjykata gjeti se pranimi i fajësisë është i plotë dhe bindës dhe se është në pajtim me provat e bashkangjitura në shkresat të lëndës, po ashtu gjeti se në veprimet e të akuzuarit, manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale, Mbajtje në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, për çka edhe e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë matjes së dënimit për të akuzuarin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konformë nenit 73 të KPRK-së. Gjkata nuk gjeti rrethana rënduese, kurse si rrethana lehtësuese të akuzuarit mori se më parë nuk ka qenë i gjykuar, është penduar thellë për veprën penale të kryer, ndërsa si rrethanë veçanërisht lehtësuese mori pranimin e fajësisë për veprën penale të kryer, ashtu që ka bërë zbutjen e dënimit konformë nenit 75 dhe 76 të KPRK-së, dhe të akuzuarin e dënoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar është ekuivalent me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit dhe se do të ndikojë në risocializimin dhe në riedukimin e të akuzuarit si dhe të mos kryejnë vepra penale çka është edhe qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e armës u mor konformë nenit 62 lidhur me nenin 69 të KPRK-së.

Vendimi mbi obligimin e të akuzuarit për pagimin e paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të nenit 450 par.2 nën par. 2.6 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.318/16, datë 03.10.2016**

**Sekretarja juridike,**  
**Fahrije Beha**

**Gjyqtarja,**  
**Afërdita Bytyçi**

**KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej  
15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit,  
përmes kësaj gjykate.